



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 46, datë 20.03.2025

PËR

**“CAKTIMIN E ZOTIT GENTIAN HABAZAJ NË DETYRËN E PROKURORIT NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar (në mungesë)
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 20.03.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktimin e zotit Gentian Habazaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”



KOPJE WEB

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacionin shoqërues nr. 1001 prot., datë 18.03.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotit Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me vendimin nr. 285, datë 17.07.2023, *“Për shpalljen e dy vendeve vakante për t’u plotësuar me procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli dy vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.
3. Në datë 26.07.2023 në faqen zyrtare web të Këshillit janë listuar kushtet ligjore, afatet që duhet të plotësojnë kandidatët për këto pozicione. Në vijim, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikoi plotësimin e kushteve ligjore të kandidatëve. Këshilli me vendimin nr.294, datë 19.09.2023, miratoi listën e kandidatëve të cilët plotësonin kushtet ligjore të përcaktuara në kohën e kandidimit.
4. Në zbatim të procedurës administrative për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në zbatim të neneve 9 pika 2 dhe 14 pika 1 të Rregullores *“Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” (në vijim Rregullorja)*, janë njoftuar nga ana e Relatorit kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion, në rrugë elektronike (me e-mail) në datë 30.12.2024, për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.
5. Në kushtet kur nuk ka pasur kërkesa për përjashtim, është vijuar puna për vlerësimin krahasimor të kriterëve të vlerësimit të kandidatëve, bazuar në nenin 43 pika 7 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim ligji nr.96/2016)* si dhe në nenet 16, 17, 19 dhe 41 të Rregullores.
6. Këshilli me vendimin nr. 22, datë 13.02.2025, miratoi renditjen e kandidatëve për pozicionin vakant Nr. 2, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 285, datë 17.07.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë:



KOPJE WEB



1. Vitjuna Mata
2. Gentian Habazaj
3. Blerta Hamza

7. Në dispozitivin e vendimeve të mësipërme është vendosur njoftimi i kandidatëve, si dhe e drejta për ankim ndaj vendimit të miratuar. Ndërkohë që rezulton se vendimi i lartpërmendur nuk është ankimuar gjyqësisht.
8. Për sa më sipër, si dhe në zbatim të nenit 45 të Rregullores për “Procedurën e lëvizjes paralele të prokurorëve”, ku parashikohet se : “ 1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizje paralele mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. 2. Vendim i Këshillit i njoftohet prokurorit të transferuar, prokurorive respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të prokurorit të transferuar.”, Këshilli vijon me procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.
9. Referuar sa më sipër, nga verifikimet rezulton se, në pozicionin vakant Nr.1 shpallur me vendimin e Këshillit nr. 285, datë 17.07.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u kualifikua për caktim në detyrë kandidatja Vitjuna Mata.
10. Në këto kushte, kandidatë në garë për pozicionin Nr.2, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 285, datë 17.07.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë:

1. Gentian Habazaj
2. Blerta Hamza

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

11. Meqenëse për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë prokurori Gentian Habazaj është kandidat i kualifikuar, i renditur i pari, Komisioni i propozon Këshillit të vijohet me caktimin në detyrë të prokurorit Gentian Habazaj në pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
12. Ky prokuror aktualisht është i komanduar pranë Këshillit si Këshilltar Ligjor, me vendimin nr. 46, datë 23.02.2023, me afat komandimi i cili fillon në datë 15.03.2023 dhe përfundon në datë 14.03.2028. Komandim i tij nuk pengon caktimin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele. Referuar nenit 57, pika 2 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, komandimi mund të ndërpritet vetëm me kërkesë të magjistratit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e zotit Gentian Habazaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr. 2 shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 285, datë 17.07.2023.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duke filluar nga data 01.04.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Gentian Habazaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi më 01.04.2025 dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 20.03.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erion Fejzulla